



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETESISË DHE MBROJTJES SOCIALE
SPITALI UNIVERSITAR OBSTETRIK - GJINEKOLOGJIK
“MBRETËRESHA GERALDINË”
“NJËSIA E PROKRUIMIT”

Nr.222/ _____Prot

Tiranë, më datë __.__.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: *“Blerje kite reagent dhe materiale konsumi marrëveshje kuadër me disa operatore ekonomike (një OE te vetëm te suksesshëm për secilin lot) ku te gjitha kushtet janë te përcaktuara - me afat 24 muaj”*

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

33696400-0 - Reagentë për laborator

VLERA E FONDIT LIMIT:

Lot I: në vlerën totale 1,162,400 (Një milion e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e katërqind) lekë pa TVSH.

Lot II: në vlerën totale 9,775,926.67 (Nëntë milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e njëzet e gjashtë.67) lekë pa TVSH.

Totali: *9,775,926.67 + 1,162,400 = 10,938,326.67 (Dhjetë milion e nëntëqind e tredhjet e tetë mijë e treqind e njëzet e gjashtë.67) lekë pa TVSH.*

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti kontraktor **SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë”** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 29 te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik“, ne te cilen eshte e parashikuar se:

1. *Oferta ekonomike përmban vlerën ekonomike pa TVSH.*
2. *Operatori ekonomik duhet të hartojë në mënyrë të pavarur, ofertën ekonomike.*

b. Lista e cmimeve te artikujve, sipas Shtojces 2:

Argumentimi: Kjo shtojce eshte pjese e setit te dokumenteve standarte te tenderit per proceduren e prokurimit te sipercituara.

c. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8:

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020“Për Prokurimin Publik“ i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”,ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. *Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*”.

d. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) *vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;*
- b) *çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

- a) 1. Paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga OE, vlera e xhiros duhet te jete jo me e vogël se 40%, të vlerës së përllogaritur të kontratës, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, sipas parashikimeve në nenin 43, të RPP.

Shënim*: *Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do te aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme për lotin që ofertohe, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” ne piken 2.10 / ose / 2.14 ”Përshkrimi i shkurtër i Loteve”.*

Shënim*: *Nëse operatorët ekonomik nuk arrijnë që të paraqesin xhiron e sipërcituar për vitin 2023 për efekte të mbyllje të vitit fiskal, mund të paraqesin xhiron vjetore për vitet (2020, 2021 dhe 2022).*

Nëse operatorët ekonomikë, që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur

Argumentimi: Ky kriter, është vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162/2020, "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, ne te cilin gjejme te percaktuar se: *3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.; ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar,(...); Vendosija e ketij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/c te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet në Procedurën e Hapur, ku percaktohet; Pika2/c: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, .; Referuar ne vleren e fondit limit te kesaj procedure AK ka menduar se vendosja e nje vlere minimale te xhiros **sa 40 % e vlerës së fondit limit***, është një deshmi e mjaftueshme per te krijuar bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operoret Ekonomike ofertues zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 'Mbi Rregullat e Prokurimit Publik' ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 61 të Ligjit nr. 29, datë 30.03.2023 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit

për Deklaratën tatimore vjetore; (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Lidhur me kërkesat për përvojën e ngjashme, OE, duhet të ketë realizuar një kontratë me vlera totale jo më të vogël se 20 % të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Si dëshmi për përvojën e mëparshme me një ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës së bashku me kontratën e lidhur ose/dhe fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes**, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, **ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.**

Shënim: Për efekt të përllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, 20% do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar për këtë procedurë prokurimi, konkretisht mbi vlerat e kolonës “Vlera e pritshme e kontratave” në piken 2.10 / ose / 2.14 “Përshkrimi i shkurtër i Loteve”.*

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik”, në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilin është e përcaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës

së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësi teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvajave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësi e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 4 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvajën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Autoriteti Kontraktor SUOGJ “Mbretëresha Geraldinë” Tiranë është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësi teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvajave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësi e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

2. Ofertuesi duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 dhe ISO 13485:2016, për import, eksport, tregtim të materialeve mjekësore/ose/ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: *Ky kriter gjen mbështetje në pikën 2 dhe 4, të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”*

Nga sa më sipër cituam, cmojmë se kerkimi i dokumentit që parashikohet në pikën b) të kapacitetit teknik është në përputhje me ligjin përkatës në RSH.

3. Ofertuesi duhet të paraqesë skedën përkatëse të produktit/katalogje apo fragmente të katalogut/gjeve, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të hollësishme për artikujt objekt prokurimi. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron (*te markuara sipas artikullit*). Katalogët do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumentimi: *Ky kriter u vendos në mbështetje të pikës 2 dhe 4, të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, Kerkimi i dokumentit që parashikohet në pikën c) të kapacitetit teknik është në përputhje me ligjin përkatës në RSH.*

5. Kërkohe vetedeklarim për materialet mjekësore nga ofertuesi (*distributor/prodhuesi*) për konformitetin me normat MDD 93/42/EÇ ose 98/79/EC ose 2015/1535/EU, bashkëlidhur me kopjet e certifikatave përkatëse CE/DC (Deklarate konformiteti) **kur është e aplikueshme**, sipas direktivave dhe **klasifikimit të Këshillit të Europës, origjinale ose fotokopje të përkthyer dhe të noterizuara të vlefshme në momentin e dorëzimit.**

6.

Argumentimi: Kriteri i vendosur në germën d) është vendosur nga anetari i NjP që ka specialitet përkatës në lidhje me kriteret teknike si dhe është në përputhje me nenin 4 pika 38/b, nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar . Deklarata mbi origjinën e mallit (kompaninë prodhuese dhe vendi prodhimit) si dhe deklarata për plotësimin e afatit të skadencës së mallit të ofruar, është kërkuar në mënyrë që me ane të saj do të bëhet krahasimi i ofertes, barnave që ofrohen nga OE me autorizimin e prodhuesit dhe dokumentacionin teknik që do të paraqitet në SPE.

Shenim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetedeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetedeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetedeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushes për këto pika do të jetë kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetedeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.
- Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personatme aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

LOT I BLERJE MATERIALE KONSUMI LABORATORIKE PER KRYERJEN E ANALIZAVE

STANDARTET DHE KERKESAT PER MARRJEN E KAMPIONEVE TE GJAKUT:

Standartet dhe kërkesat e përgjithshme të sistemit të marrjes së gjakut:

- Tubat dhe aksesoret duhet të kenë markën CE për të siguruar kualitetin e produktit.
- Tubat dhe aksesoret duhet të jenë të prodhuar sipas standarteve të ISO 6710:2017
- Tubat e gjakut duhet të jenë në përputhje me "Direktiven europiane të pajisjeve mjekësore për diagnostikën in vitro 98/79/EC".
- Tubat dhe aksesoret duhet të jenë të sterilizuara. Procesi i sterilizimit të jete në përputhje me EN ISO 11135/11137/17665 dhe EN 556.
- Tubat dhe aksesoret e tubave duhet të jenë pjesë e një sistemi të mbyllur të marrjes së gjakut në përputhje me kërkesat e OBSH dhe CLSI.
- Sistemi i marrjes së gjakut përfshin tubat me vakum, aget flutur dhe kapucat mbajtës.
- Tapat e tubave të jenë me ngjyra të përcaktuara sipas rekomandimeve të EFLM në varësi të disiplinave laboratorike ku ato do përdoren.
- Tapat e tubave të rutinës duhet të jenë të pajisura me sistemin e mbylljes "Hemogard" i cili izolon tubat e mbledhjes të gjakut, duke siguruar mbrojtjen e personelit mjekësor nga kontakti me gjakun. Një mbyllje e tillë bën të mundur që gjaku mos spërkatet kur tubi të hapet.

- Tubat duhet te kenë të shënuar volumin e mbushjes dhe nivelin e mbushjes.
- Tubat duhet të kenë të shënuar datën e skadences, simbolin e sterilizimit, lotin përkatës dhe tipin e antikoagulantit/aditivit që përmbajnë.
- Tubat dhe aksesoret e marrjes së gjakut duhet të jenë një përdorimesh dhe të kenë sisteme sigurie të përditësuara.

Afati dhe kushtet e lëvrimit të mallit:

- Paketimi njësi dhe volumi për secilin artikull është përcaktuar në tabelle
- Konfeksionimi: Mbi çdo konfeksion duhet të jete shënuar emri i artikullit, sasia njësi, data e prodhimit dhe e skadimit, nr. serisë dhe firma prodhuese.
- O.E duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor deklaratën mbi paketimin e jashtëm të artikullit.
- Afati i skadences duhet të jete jo më i vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadences.
- Lëvrimi i mallit të behet sipas afatit të përcaktuar për secilin artikull në tabelle sipas kërkesës së Autoritetit Kontaktor.

Lot.1 Blerje materiale konsumi laboratorike për kryerjen e analizave”.

Specifikimi i Materialeve:

Materiale konsumi laboratorike për kryerjen e analizave					AFATI I LEVRIMIT
Nr	Emertimi	Specifikimet	Njesia	Sasia	
Hematologji:					
1	Tub me tape lejla		cope	24,000	30% e sasisë brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës pjesa tjetër sipas nevojave të AK-se.
		Volumi: 2-4 ml,			
		Dimensionet: 13x75 mm,			
		Aditivi: K2EDTA/K3EDTA,			
		Sistemi i mbylljes: Hemogard,			
Materiali: PET					
Koagulim:					
2			cope	15,000	

	Tub me tape blu	Volumi: 2.7-4.5ml , Dimensionet: 13x75 mm, Aditivi: Trisodium citrate (3.2-3.8 %), Sistemi i mbylljes: Hemogard, Materiali: PET/PP/			30% e sasisë brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës pjesa tjetër sipas nevojave të AK-se.
Kimi klinike/Imunologji:					
3	Tub për ndarje të shpejtë serumit me tape portokalli për urgjencat	Volumi: 5ml, Dimensionet: 13x75 mm, 13x100mm, Aditivi: Thrombin based clotting agent, Sistemi i mbylljes: Hemogard, Materiali: Plastike PET, Minimum clotting time: 5 min	cope	5,000	30% e sasisë brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës pjesa tjetër sipas nevojave të AK-se.
4	Tub për plazmën me tape jeshile	Volumi: 2-4ml, Dimensionet: 13x75 mm, Aditivi: Litium-Heparine, Sistemi i mbylljes: Hemogard,	cope	5,000	30% e sasisë brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës pjesa tjetër sipas nevojave të AK-se.

		Materiali: Plastike PET			
Specifikimet e aksesoreve te sistemit te marrjes se gjakut:					
5	Gjilpere shpuese per marrjen e gjakut te foshnjave		cope	5,000	30% e sasisë brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës pjesa tjetër sipas nevojave te AK-se.
		Tashesia: 21-22G,			
Gazet ne gjak:					
6	Shiringe per marrje gjaku	Additivi: Spray calcium-balanced litium heparine,		5,000	30% e sasisë brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës pjesa tjetër sipas nevojave te AK-se.
		Volumi:1-3ml,			
		Madhesia: 21-22G			
Tubat pediatrike me volum te vogël:					
7	Tub K 2 EDTA			10,000	30% e sasisë brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës pjesa tjetër sipas nevojave te AK-se.
		Volumi: 1-2ml,			
		Sistemi i mbylljes: Microgard			
Specifikimet e aksesoreve te					
8	Gota sterile për urine		cope	6,000	30% e sasisë brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës pjesa tjetër sipas nevojave te AK-se.

9	Tamponë Sterile	tub plastik individual me shkop	cope	1,500	30% e sasisë brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës pjesa tjetër sipas nevojave të AK-se.
Materiale konsumi të mikrobiologjise					
10	Tuba (bujone) me terren të lëngshëm Thioglycolate	Shishe	cope	600	30% e sasisë brenda 30 ditëve nga lidhja e kontratës pjesa tjetër sipas nevojave të AK-se.

LOT 2 Blerje kite dhe reagente për laboratorin gjenetik.

Specifikimi i Materialeve:

Kitet dhe reagentet nevojiten për testet gjenetike, për nevojat e spitalit tonë.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

1. Kitet duhet të jenë të përshtatshme për analizatorin gjenetik SeqStudio.
2. Kitet e metodës StripsAssay duhet të jenë të përdorshme për diagnostikë molekulare.
3. Kitet dhe reagentët duhet të jenë të certifikuar sipas CE.
4. Ambalazhimi të jetë i përshtatshëm dhe i tillë që të mos lejojë dëmtimin gjatë lëvizjes dhe transportit.
5. Të kenë afat skadence jo më të vogël se 1/2 kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadimit nga data e dorëzimit në SUOGJ “Mbretëresha Geraldine”.
6. Të shoqërohen në momentin e dorëzimit, me dokumentat:
 - Çertifikatën e garancisë të lëshuar nga operatori ekonomik;
 - Çertifikatën e origjinës së mallit.
7. Operatori ekonomik duhet të marrë përsipër blerjen, transportin dhe furnizimin deri në adresën e autoritetit kontraktor.

Afati dhe kushtet e lëvrimit të mallit:

- Paketimi njësi dhe volumni për secilin artikull është përcaktuar në tabele
- Konfeksionimi: Mbi çdo konfeksion duhet të jete shënuar emri i artikullit, sasia njësi, data e prodhimit dhe e skadimit, nr. serisë dhe firma prodhuese.
- O.E duhet të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor deklaratën mbi paketimin e jashtëm të artikullit.
- Afati i skadences duhet të jete jo më i vogël se 1/2 e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skadences.

- Lëvrimi i mallit te behet sipas afatit te përcaktuar për secilin artikull ne table sipas kërkesës se Autoritetit Kontaktor.

Specifikimet e materialeve: Blerje materiale konsumi laboratorike per kryerjen e analizave”

Nr.	EMERTIMI I MATERIALIT/ SPECIFIKIMET TEKNIKE	METODA	PAKETIMI	NJESIA	SASIA PER PLANIFIKIM	AFATI I LEVRIMIT
1	Taq DNA polymerase	PCR	Kuti 500 units	kit	4	Sipas nevojave te AK-se
2	Seq Studio cathode Buffer	Sekuencim	Kuti 4 shishe 25 ml	Shishe	52	Sipas nevojave te AK-se
3	TaqGold Polymerase	PCR	Kuti 250 units	kit	8	Sipas nevojave te AK-se
4	SALSA MLPA probemix P095 aneuploidy	MLPA	25 reaksione	Kit	2	Sipas nevojave te AK-se
5	Epruveta sterile ependorf 1.5 ml	Konsum njeperdorimesh	Qese sterile (500/1000 cope)	cope	2	Sipas nevojave te AK-se
6	Maja pipetash sterile dhe me filter 1-10 µL	Konsum njeperdorimesh	Kuti 96 cope	kuti	20	Sipas nevojave te AK-se
7	Maja pipetash sterile dhe me filter 200 µL	Konsum njeperdorimesh	Kuti 96 cope	kuti	20	Sipas nevojave te AK-se
8	Maja pipetash sterile 1000 µL	Konsum njeperdorimesh	Kuti 96 cope	kuti	20	Sipas nevojave te AK-se
9	Eppendorf PCR tube strips me kapak (0.2 ml, jo sterile)	Konsum njeperdorimesh	Strips 8 njesi	cope	200	Sipas nevojave te AK-se
10	Agarose, LE, per biologji molekulare	Konsum njeperdorimesh	shishe (100 gr)	Shishe	2	Sipas nevojave te AK-se
11	kit per aueuploidi te kromozomeve 15, 16, 22	QF-PCR	26 teste	Kit	8	Sipas nevojave te AK-se
12	Kit per aneuploidi te kromozomeve 13, 18, 21, X, Y XY	QF-PCR	68 teste	Kit	8	Sipas nevojave te AK-se
13	HiDi Formamide genetic analyzer grade for SeqStudio	Sekuencim	Shishe 25 ml	shishe	10	Sipas nevojave te AK-se
14	Blood Kit DNA extraction Invitrogen	eskstraktim	Kit 50 ekstraktive	Kit	6	Sipas nevojave te AK-se

15	SALSA MLPA Probemix P034 DMD-1, (25R)	MLPA	25 reaksione	kit	2	Sipas nevojave te AK-se
16	SALSA MLPA Probemix P035 DMD-2, (25R)	MLPA	25 reaksione	kit	2	Sipas nevojave te AK-se
17	SALSA MLPA Probemix P060(25R)	MLPA	25 reaksione	Kit	2	Sipas nevojave te AK-se
18	EK1 Cy5 SALSA MLPA reagent mix	MLPA	25 reaksione	Kit	2	Sipas nevojave te AK-se

Argumentimi: Specifikimet teknike jane vendosur ne baze te relacionit te grupit te punes si dhe ne perputhje me nenin 4, pika 38/b te **Ligjin nr. 162/2020**, “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, nenin 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Për lotin I janë detyrime të dnër sjellta që burojnë nga Kontrata e PPP-së lidhur mes MSHMS-së dhe Partnerit Privat. Bazuar ne kontratën Nr.1924/2 prot, date 10.04.2019 “*Kontrate partneriteti publik-privat për ofrimin e shërbimeve laboratorike mjekësore*” ndërmjet MSHMS dhe koncesionarit “Laboratory Netëork” shpk ku sipas shtojcës nr. 9 institucioni ynë është pale përfituese e këtij shërbimi dhe referuar pikës 15 “*Kërkesë për marrjen e kampioneve te gjakut*” te “Marrëveshjes se Ndërveprimit” Nr.71prot. date 26.01.2021 te nënshkruar ndërmjet “Laboratory Netëork” shpk dhe institucionit tone kërkohet qe te realizohet procedura e prokurimit për “*Blerjen e materialeve konsumabel te laboratorëve*”, ku ne mënyre te detyrueshme te respektohen kërkesat dhe standardet e kërkuara për furnizimin me materiale laboratorike duke shmangur riskun e refuzimit te kampioneve dhe mos dhënien e shërbimit. Lot II, si nje qendër e gjenetikës në RSH kemi laboratorin e diagnostifikimit të problemeve gjenetike tek nënat dhe bebat duke analizuar dhe argumentuar sëmundje si Daën, etj...

NJËSIA E PROKURIMIT: